

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarene vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, me zyrтарin ligjor Leutrim Hoti, në çështjen penale, kundër të pandehurit **S.M.**, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.4046/17, të dt.21.11.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, PP.nr.4046/17, të dt.21.11.2017, më dt.**24.01.2018**, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.4046/17, të dt.21.11.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMORË

I pandehuri: S.M., i lindur me dt...., me vendbanim në fshatin P.1, Komuna e P.2, me nr. ID...., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

S e p s e:

Me dt.30.07.2017, rreth orës 12:00 min, në Rr.” P.V.” në P., i pandehuri derisa ishte duke drejtuar automjetin e tipit “Mercedes” me ngjyrë të zezë, me targa ..., ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 par.1 të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugorë, Ligji Nr.02/L-70, duke rrezikuar jetën e njerëzve në atë mënyrë që gjatë kyqjes nga rruga dytësore, duke mos i kushtuar rëndësi rrugës me përparësi kalimi, me pjesën e parë ballore e godet automjetin “Audi”, me ngjyrë të kuqe me targa ..., duke shkaktuar kështu lëndime të lehta trupore që kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit tek të dëmtuarit S.K., S.G., E.G. dhe A.G.,-

- me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **me 3 (tri) këste**.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet)€ të gjobës.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet procedurale aq sa do të jenë sipas llogarisë së kësaj gjykate, dhe në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit S.K., me vendbanim në G. e Ll., S.G., E.G. dhe A.G., të trijame vendbanim në Rr. "A.S." në F.K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.nr.4046/17, të dt.21.11.2017, e ka akuzuar **S.M.**, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Raporti i Aksidentit 2017-AR-1677, i datës 30.06.2017, akt ekspertimi mjeko-ligjor në bazë të dokumenteve të çështjes i datës 24.10.2017, ekspertiza e komunikacionit e datës 13.10.2017, dhe foto dokumentacioni me shkresat e tjera janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Pas vlerësimit me shumë kujdes të të gjitha provave materiale të lartcekura, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë nga: ekspertiza e ekspertit së komunikacionit A.M. i cili ka konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimevetë ngasësit të automjetit "A", Daimler Chrysler, ku i njëjti gjatë kyqjes nga rruga dytësore "P.V." në rrugën kryesore "R.D.", merr veprimin e kyqjes duke mos i kushtuar kujdes rrugës me përparësi kalimi ashtu që me të filluar kyqjen e godet me pjesën e parë ballore, në pjesën anësore të anës së djathtë (derën e parë dhe të pasme), automjetin B i cili ka qenë duke lëvizur në rrugën me përparësi kalimi. Në këtë mënyrë vjen deri te aksidenti i trafikut në komunikacion me lëndime trupore dhe dëme materiale.

Në bazë të mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr, F.D. të datës 24.10.2017, për të dëmtuarit, lidhur me natyrën dhe shkallën e lëndimeve trupore rezulton se i dëmtuari S.K. si pasojë e aksidentit ka pësuar ndrydhje (mbrejtje) të indeve të buta, të regjionit iJOR (lumbal) të shputës së këmbës së djathtë dhe përdredhje të indeve të butatë qafës, e dëmtuara S.G. ka pësuar ndrydhje (mbrejtje) të indeve të buta të kokës dhe regjionit të qafës, e dëmtuara E.G. ka pësuar ndrydhje (mbrejtje) të indeve të buta të qafës dhe regjionit të supit të krahut të djathtë, e dëmtuara A.G. ka pësuar ndrydhje (mbrejtje) të indeve të buta të qafës dhe regjionit të supit të krahut të dorës së djathtë, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit mbretës (jo i mprehtë, i topitur), dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Duke u bazuar në këto që u cekën me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri S.M., është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, është marr në bazë të nenit 450 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, palët e dëmtuar janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.5307/17, i dt.24.01.2018

Zyrtari Ligjor
Leutrim Hoti

Gjyqtarja,

Lumnije Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimin të tij, në këtë gjykatë.